

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Xhevndet Abazi, kryetar, Have Haliti dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit T.A., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga nenin 189 par. 5 lidhur me par 1 dhe nën par. 1.3 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, ankesës dhe përgjigjes në ankesë të Prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit T.A., av. Xh.H., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.93/2018, i datës 20.06.2018 në seancën e kolegjit të mbajtur konformë nenit 390 të KPPK-së, me datë 16.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen, si të pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesa e mbrojtësit të mbrojtësit akuzuarit T.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.93/2018, i datës 08.05.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.93/2018, të datës 08.05.2018, i akuzuari T.A., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga nenin 189 par. 5 lidhur me par 1 dhe nën par. 1.3 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, të cilin dënim i akuzuari do ta mbajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 12.04.2018 deri më 24.05.2018 dhe në arrest shtëpiak nga data 24.05.2018 deri më 20.06.2018.

I akuzuari, është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30(tridhjetë) €, si dhe 50 (pesëdhjetë) €, për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Kundër aktgjyqimit në afat ligjor ankesë ka paraqitur,

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarit T.A.t ti shqiptoj një dënim më të ashpër.

Mbrojtësi i të akuzuarit T.A., av. Xh.H., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të ulët.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantuan i akuzuari T.A., mbotjësi i tij av. Xh.H., kurse nuk prezantuan Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari Herolind Avdyli, edhe pse janë nftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën Prokurorisë Themelore në Gjilan, ankesën dhe përgjigjes në ankesë të Prokurorisë së mbrojtësit të akuzuarit av. Xh.H. dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë, gjeti se :

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit janë të pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e aktgjyimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Prokuroria në ankesë pretendon se dënimi nuk është në proporcion me veprën penale që ia vë në barrë të akuzuarit, nuk i përgjigjet intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallës së përgjegjësisë të akuzuarit dhe pasojës së veprës penale, se gjykata nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar sipas ligjit, sepse dënimi i dhënë është në kundërshtim me kufijtë e zbutjes së dënimit sipas nenit 74,75 dhe 76 të KPPK-së, se rrethanat lehtësuese të potencuara në aktgjykim në asnjë mënyrë nuk kanë mundur të vlerësohen, kur kihet parasysh vendi i kryerjes së veprës si dhe mënyra e kryerjes së saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se i dënimit është shumë i ashpër, se në prezencën e shumë rrethanave jo vetëm lehtësuese por edhe posaçërisht lehtësuese, siç është pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit që në fillim të procedurës, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmë nuk do të kryej vepra tjera penale, se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë dhe se ndaj të njëjtit nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, rrethana këto që gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh gjatë shqiptimit të dënimit, duke i marrë për bazë rrethanat rënduese, dashjen për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore, përgjegjësinë penale, të cilat rrethana janë elemente qenësore të veprës penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, andaj konsideron se dënimi i shqiptuar është tejet i lartë dhe në kundërshtim me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, se me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Kjo gjykatë gjen se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, ka marrë parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjatë seancës së dytë, ka shfaqur keqardhje për veprën e kryer penale, i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe se është i moshës së re, ndërsa rrethana rënduese gjykata ka pasur parasysh mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprës penale duke qenë se vepra është kryer në vend publik dhe vendosmërinë e të akuzuarit për kryerjes së veprës.

Duke i pasur parasysh rrethanat personale të akuzuarit si dhe pranimin e fajësisë, me të drejtë ka aplikuar dispozitat e nenit 73 të KPK-së, të zbutjes së dënimit dhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj, mbrojtësi i të akuzuarit nuk thekson asnjë rrethanë konkrete lehtësuese e cila do të ndikonte që dënimi të jetë më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë e cila në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësues, e as prokuroria nuk ka paraqitur rrethana tjera rënduese që të i shqiptohet dënim më i lartë, prandaj pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, si dhe pretendimi i prokurorisë se dënimi i shqiptuar është i ulët, janë pretendime të pa pabazuara, se gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënim me burgim nën minimumin ligjor të paraparë për këtë veprë penale. Vlerësimet e këtylla të gjykatës së shkallës së parë i pranon edhe kjo gjykatë, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.350/18, të dt. 16.08.2018

Procesmbajtësja,
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit
Xhevdet Abazi

1. Have Haliti
2. Abdullah Ahmeti